



- ▶ **Ministri**
- ▶ **Zv. Ministrat**
- ▶ **Kabineti i Ministrat**
- ▶ **Ministria e Mbrojtjes**
- ▶ **Forcat e Armatosura**
- ▶ **Administrata Publike**
- ▶ **Arsimimi Ushtarak**
- ▶ **Misionet Paqeruajtëse**
- ▶ **Asgjesimi i Municioneve**
- ▶ **Industria Ushtarake**
- ▶ **Direktiva e Mbrojtjes**
- ▶ **AKSHE**
- ▶ **Kontakt**
- ▶  **Parashikimi i Motit**
- ▶  **Posta Elektronike**

## Ministri i Mbrojtjes, Arben Imami dhe Presidenti i Fondacionit të Mesdheut i dorëzojnë Medaljen e Paqes Presidentit Masoud Barzani

E diel, 18 Mars 2012 16:13



*Presidenti Barzani merr Medaljen e Paqes, ministri Imami i ftuar i posaçëm.*



Ministri i Mbrojtjes, z. Arben Imami, ishte i ftuar i posaçëm për t'i dorëzuar "Medaljen e Paqes" akorduar nga Fondacioni i Mesdheut, Presidentit të Rajonit Kurd të Irakut, z. Masoud Barzani. Ceremonia u zhvillua me datë 17 mars në kryeqytetin e këtij Rajoni, Erbil, ku ishin të pranishëm President i delegacionit italian në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, senatori Sergio de Gregorio, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Atlantikut të Veriut, Troels Froling dhe shumë personalitete të tjera të politikës europiane.

Ministri i Mbrojtjes, Arben Imami ishte i ftuar në këtë ceremoni nga Presidenti i Fondacionit të Mesdheut, Michele Capasso, i njohur për dedikimin ndaj paqes dhe vlerësimit të figurave të mëdha politike që kanë kontribuar për paqen dhe stabilitetin në botë. Gjatë ceremonisë, Ministri Imami vlerësoi rolin e Presidentit Barzani për paqen dhe stabilitetin në Irak dhe në rajonin e Lindjes së Afërme, si dhe kontributin e tij të veçantë për ndërtimin e një shteti irakian demokratik dhe të stabilizuar.

"Ne vlerësojmë rolin tuaj personal për stabilitetin e Irakut, dedikimin tuaj ndaj popullit tuaj dhe ndaj paqes e sigurisë në tërësi. Vendosmëria juaj për të promovuar bashkëjetesën paqësore ndërmjet popujve me etnitete dhe fe të ndryshme e ka bërë Rajonin Kurd të Irakut një model për të gjithë Lindjen e Afërme," - u shpreh z. Imami. Gjithashtu, ministri Imami theksoi faktin se ky ishte vendi ku kishin lindur dhe bashkëjetuar me shekuj të tërë fetë më të mëdha, dhe ky ishte një monument i njerëzimit, i cili duhet mbrojtur dhe promovuar nga të gjithë.

Presidenti Barzani falënderoi Fondacionin e Mesdheut për dhënien këtij titulli të rëndësishëm dhe u shpreh se populli kurd, pavarësisht vuajtjeve që ka pësuar gjatë historisë, nuk do të kërkojë hakmarrje, por do të kontribuojë për paqen dhe stabilitetin në rrugë paqësore.

Gjatë qëndrimit të tij në Erbil, ministri Imami zhvilloi gjithashtu një seri takimesh me ministra të qeverisë së Rajonit Kurd të Irakut, ku u diskutua për fusha të ndryshme bashkëpunimi midis dy palëve.

Rajoni Kurd i Irakut ka përjetuar zhvillim të shpejtë gjatë viteve të fundit, për shkak edhe të rritjes së nivelit të sigurisë dhe garantimit të stabilitetit të brendshëm politik.

 Kërko 
[Foto Galeri](#)
[Video Galeri](#)


PLANI I INTEGRUAR I  
MBROJTJES 2010



Prokurimet  
Publike

Anti korrupsion  
800 11 22

Ankande  
në FA

PRONAT E USHTRISE  
JASHTË FA

Gazeta  
Ushtria

Simbolet

revista  
Mbrojtja

### Të ndryshme nga mediat:

#### BBC - NATO Mirëpret Shqipërinë

Shqipëria i është bashkuar zyrtarisht aleancës ushtarake, bashkë me Kroacinë. Të dy shtetet u bënë anëtarët e 27 e të 28 të NATO-s pas një ceremonie në Washington.  
[Lexo të Plotë...](#)